



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 98 /2024

Datë: 15 janar 2024

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.25 të Ligjit Nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe nenit 9 të Rregullores Nr.02/2022 për Rekrutimin, Provimin, Emërimin dhe Riemërimin e Prokurorëve të Shtetit, në takimin e mbajtur me datë 15 janar 2024, mori këtë:

VENDIM

- I. Themelohet Komisioni për Rishqyrtim, në këtë përbërje:
 1. Arian Gashi, Anëtar i Këshillit Prokurorial të Kosovës - Kryesues;
 2. Bahri Hyseni, Prokuror në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit- Anëtar;
 3. Bedrije Alshiqi, Prokurore në Prokurorinë e Apelit – Anëtare;
- II. Anëtarë rezervë të Komisionit për Rishqyrtim do të jenë:
 1. Merita Bina Rugova, Anëtare e Këshillit Prokurorial të Kosovës - Anëtare;
 2. Arben Ismajli, Prokuror në Prokurorinë e Apelit – Anëtar;
- III. Obligohen anëtarët nga pika I dhe pika II të këtij Vendimi që detyrat dhe përgjegjësitë tyre ti ushtrojnë në bazë të Rregullores Nr.02/2022 për Rekrutimin, Provimin, Emërimin dhe Riemërimin e Prokurorëve të Shtetit .
- IV. Obligohet Sekretariati që këtë Vendim ta publikojë në Ueb portalin e sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës.
- V. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Jetish Maloku
Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

T'i dërgohet:

- Anëtarëve në piken I dhe II të këtij Vendimi;
- Sekretariatit të KPK-së;
- Arkivit të KPK-së.